



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 25

Prishtinë, më 9 korrik 2010, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni – kryetar, Gani Geci, Adem Hajdaraj, Bajram Kosumi, Ramadan Gashi, Radmila Vujoviq, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Selviqe Halimi, Kolë Berisha dhe Mufera Şinik.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Gani Koci – kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Agron Bajrami – MD, Lumniqe Murati – ZPRK, Isuf Zejna – KDI, Saniqe Berisha -OSBE dhe Albulena Ademi – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit: Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa në P/L për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë,
3. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa në P/L për administratën tatimore dhe procedurat,
4. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa në P/L për ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-112 për tatimin e normës së akcizës në Kosovë, dhe në P/L për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në P/L për grevat,
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa në P/L për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

Kryetari paraqiti për shqyrtim Propozimamendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa në P/L për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen nëse kanë vërejtje eventuale.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

PËRFUNDIM

I. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional e kanë bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

II. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare të Kuvendit.

3. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa në P/L për administratën tatimore dhe procedurat

Kryetari paraqiti për shqyrtim propozimamendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa në P/L për administratën tatimore dhe procedurat dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen nëse kanë vërejtje eventuale.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

PËRFUNDIM

I. Projektligji për administratën tatimore dhe procedurat dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional e kanë bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

II. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa në P/L për ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-112 për tatimin e normës së akcizës në Kosovë, dhe në P/L për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Kryetari - Paraqiti për shqyrtim Propozimamendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa në P/L për ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-112 për tatimin e normës së akcizës në Kosovë, dhe në P/L për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, ai kërkoi nga anëtarët që të deklarohen nëse kanë vërejtje eventuale.

Ibrahim Makolli - Duke ju referuar amendamentit 3 në P/L për ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-112 për tatimin e normës së akcizës në Kosovë, i reformuluar si vijon: 1 *“Qeveria e Republikës së Kosovës në konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës mund të ndryshojë normën e tatimit të akcizës në Aneksin A të bashkangjitur me këtë ligj.”*

2. *“Në raste të veçanta Qeveria e Republikës Kosovës, në konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës, mund të shtojë listën e mallrave në aneksin A të këtij ligji, që do të nënshtrohen normës së tatimit të akcizës”.* Ai tha se janë në kundërshtim me kushtetutën, sepse nuk mundet Qeveria që në konsultim me Komisionin për Buxhet ta ndryshojë normën e tatimit të akcizës dhe nuk mund të shtojë listën e mallrave. Shtoi se vetëm Kuvendi mund ta bëjë këtë, jo Qeveria, sepse në momentin kur Qeveria mund ta bëjë këtë atëherë nuk na duhet më Kuvendi, sepse me kushtetutë janë paraparë përgjegjësitë e Kuvendit dhe të Qeverisë.

Armend Zemaj - Duke u ndërlidhur me parafolësin sqaroi se Qeveria në shumë vende e ka këtë të drejtë dhe kjo ka të bëjë për mallrat që llogariten si mallra luksi, ishte i mendimit që kjo nuk është në kundërshtim me kushtetutën, por a duamë ta lejojmë kjo varet nga vullneti politik.

Gani Geci, duke u ndërlidhur me diskutimet e parafolësve mori shembull Gjermanin kur ajo ka pasur problem me fondin për sigurime shëndetësore dhe në këtë formë e kanë rritur akcizën, por kjo ka shkuar përmes Bundestagut e jo përmes Qeverisë.

Bajram Kosumi - Ishte i mendimit që këtij formulimi në fund t'i shtohet *“ dhe me miratimin nga Kuvendi “* kjo do të ishte më e pranueshme, sepse Qeveria mund të shtojë listën në konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, por në fund të miratohet nga Kuvendi.

Selvi Halimi - Ishte e mendimit që për mallrat e luksit nuk duhet të diskutohet shumë, se sa do të jetë akciza dhe ne nuk mund t'i parashikojmë sot, se cilat do të jenë ato mallra, ndërsa për mallrat e domosdoshme nuk është e paraparë. Prandaj mallrat e luksit nuk mund të radhiten në listën e mallrave të domosdoshme.

Kryetari - Kërkoi nga z. Gani Koci, kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa që ta sqarojë amendamentin 3.

Gani Koci - Në fjalën e tij paraqiti arsyetimin rreth amendamentit 3 duke shtuar se në shumicën e vendeve të Evropës të Bashkimit Evropian rreth akcizave dhe normës së akcizës vendos Qeveria, varësisht prej situatave që i krijohen. Në këtë kuptim ne për t'i ikur arbitraritetit të Qeverisë e kemi futur në konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa. Ai tha se këtë përvojë e kemi marrë nga shteti

Gjerman që çështjet e caktuara Qeveria në konsultim dhe me miratim të Komisionit pa shkuar në Kuvend merr vendime të tilla.

Kundër amendamentit 3 ishin: Ibrahim Makolli, Gani Geci dhe Bajram Kosumi.

Kryetari konstatoi se Komisioni me tetë vota “për” dhe tri “kundër” nxori këtë:

PËRFUNDIM

I. Projektligji për ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë dhe P/L për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional e kanë bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

II. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në P/L për grevat

Kryetari - Paraqiti për shqyrtim Propozimamendamentet e Komisionit Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në P/L për grevat dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen nëse kanë vërejtje eventuale.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime” nxori këtë:

PËRFUNDIM

I. Projektligji për Grevat nr. 03/L - 200 dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional e kanë bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

II. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare të Kuvendit.

6. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni